



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA Durrës
KËSHILLI BASHKIAK

PROÇESVERBAL

Nr. 1, datë 13.01.2023

I mbledhjes së Këshillit Bashkiak Durrës për muajin janar, që zhvillohet në sallën e Këshillit Bashkiak

Orari i fillimit të mbledhjes : 18 : 05

Data e mbajtjes së mbledhjes : 13.01.2023

Mbajtja e mbledhjes : Salla e Këshillit Bashkiak

Lloji i Mbledhjes: Mbledhje Jashtë Radhe

Përfaqësuesit e Bashkisë Durrës: Kryetarja e Bashkisë znj.Emiriana Sako dhe përfaqësues të drejtorive, që kanë përgatitur materialet për mbledhjen plenare.

Ani Dyrmishi: Përshëndetje !

Të nderuar Këshilltarë!

E nderuar Kryetare!

Së pari dua t'Ju uroj një vit të mbarë e të paqtë dhe shpresoj të punojmë të gjithë së bashku gjatë rrugës për rindërtimin e qytetit tonë të bukur.

Deklaroj të hapur këtë mbledhje jashtë rradhe të parë për vitin 2023 për Këshillin Bashkiak.

Kjo mbledhje, është kërkuar, nga kryetarja e bashkisë. Materialet ju janë vënë në dispozicion nga sekretarja e këshillit.

Ftoj sekretaren e këshillit të bëj prezencën në sallë.

Dorina Milja: Përshëndetje të gjithëve ! Fillojmë me prezencën.

Jolanda Mustafaraj ... prezent.....deri tek.... Morena Boja...mungon.

32 këshilltarë në sallë.

Ani Dyrmishi : Faleminderit.

Meqë kuorumi është i pranishëm, vazhdojmë me mbledhjen.

Po kaloj në leximin e pikave të rendit të ditës.

Pika 1. Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit	PËR MIRATIMIN NË PARIM TË VLERËS FINANCIARE TË SHPRONËSIMIT PREJ 48342000 (DYZETËËTETMILION E TREQINDE DYZETËËDYMIJË) LEKË, PËR PASURITË PRONË PRIVATE, SIPAS TABELËS SË HARTUAR NGA GRUPI I PUNËS, I NGARKUAR PËR KRYERJEN E VLERËSIMIT PARAPRAK, DHE ËSHTË PJESË E KËTIJ VENDIMI, QË PREKEN NGA INVESTIMI PUBLIK ME OBJEKT: “PROJEKT ZBATIMI PËR NDËRTIMIN E SHËTITORES SË PLAZHIT DURRËS, NGA URA E DAJLANIT DERI NË GODINËN E KOVALISHENCËS”
Pika 2 Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit	PËR MIRATIMIN E LISTËS SË PËRFITUESVE NGA PROGRAMI I RINDËRTIMIT NË NJËSITË ADMINISTRATIVE NR. 2, RRASHBULL, ISHËM, BASHKIA DURRËS, QË DO TË PËRFITOJNË NGA PROGRAMI I PROCESIT TË RINDËRTIMIT PËR BANESAT INDIVIDUALE TË DËMTUARA NGA FATKEQËSIA NATYRORE E TËRMETIT TË DATËS 26 NËNTOR 2019
Pika 3 Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit	PËR MIRATIMIN E LISTËS SË TREMBËDHJETË TË 11 SUBJEKTEVE PËRFITUESE, TË CILËT DO TË PËRFITOJNË MASËN E GRANTIT TË RINDËRTIMIT TË BANESAVE INDIVIDUALE TË DËMTUARA NGA TËRMETI I DATËS 26 NËNTOR 2019, SIPAS PROJEKTIT MODEL
Pika 4 Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit	PËR NDRYSHIMIN E VENDIMIT TË KËSHILLIT BASHKIAK NR.155, DATË 22.12.2022 “PËR MIRATIMIN E LISTËS SË PËRFITUESVE NGA PROGRAMI I RINDËRTIMIT NË NJËSITË ADMINISTRATIVE NR. 1,4,5, RRASHBULL, SUKTH, KATUND I RI, BASHKIA DURRËS, QË DO TË PËRFITOJNË NGA PROGRAMI I PROCESIT TË RINDËRTIMIT PËR BANESAT INDIVIDUALE TË DËMTUARA NGA FATKEQËSIA NATYRORE E TËRMETIT TË DATËS 26 NËNTOR 2019”
Pika 5 Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit	PËR MIRATIMIN E LISTËS SË PËRFITUESVE NGA PROGRAMI I PROCESIT TË RINDËRTIMIT NË NJËSINË ADMINISTRATIVE ISHËM, RRUGA "5 PRILL", PALLATI NR.15, I DËMTUAR NGA FATKEQËSIA NATYRORE E TËRMETIT TË DATËS 26 NËNTOR 2019, QË DO TË SISTEMOHEN NË ZONËN E RE PËR ZHVILLIM LALËZ, NJËSIA ADMINISTRATIVE ISHËM
Pika 6 Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit	PËR MIRATIMIN E DISA SHTESAVE NË VENDIMIN E KËSHILLIT BASHKIAK NR. 35, DATË 09.05.2022, PËRSA I PËRKET LISTËS SË PËRFITUESVE NGA PROGRAMI I PROCESIT TË RINDËRTIMIT NË NJËSINË ADMINISTRATIVE NR.4, PALLATI NR.344, RRUGA “ALEKSANDËR GOGA”, I DËMTUARA NGA FATKEQËSIA NATYRORE E TËRMETIT TË DATËS 26 NËNTOR 2019
Pika 7 Shqyrtim dhe	PËR MIRATIMIN E DISA SHTESAVE NË VENDIMIN E KËSHILLIT BASHKIAK NR. 34, DATË 09.05.2022, PËRSA I PËRKET LISTËS SË PËRFITUESVE NGA

miratim i projektvendimit	PROGRAMI I PROÇESIT TË RINDËRTIMIT NË NJËSINË ADMINISTRATIVE NR.4, PALLATIN NR.122, RRUGA “ALEKSANDËR GOGA”, I DËMTUARA NGA FATKEQËSIA NATYRORE E TËRMETIT TË DATËS 26 NËNTOR 2019
Pika 8 Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit	PËR MIRATIMIN E DISA SHITESAVE NË ANEKSIN 1 BASHKËLIDHUR VENDIMIT TË KËSHILLIT BASHKIAK NR. 49, DATË 31.05.2022, PËRSA I PËRKET LISTËS SË PËRFITUESVE NGA PROGRAMI I PROÇESIT TË RINDËRTIMIT NË NJËSINË ADMINISTRATIVE NR.2, PALLATIN NR.21, RRUGA “ISUF MOLLA”, I DËMTUAR NGA FATKEQËSIA NATYRORE E TËRMETIT TË DATËS 26 NËNTOR 2019
Pika 9 Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit	PËR MIRATIMIN E DISA SHITESAVE NË VENDIMIN E KËSHILLIT BASHKIAK NR. 37, DATË 09.05.2022, PËRSA I PËRKET LISTËS SË PËRFITUESVE NGA PROGRAMI I PROÇESIT TË RINDËRTIMIT NË NJËSINË ADMINISTRATIVE NR.3, PALLATIN NR.32, RRUGA “HYSEN KËRTUSHA, I DËMTUAR NGA FATKEQËSIA NATYRORE E TËRMETIT TË DATËS 26 NËNTOR 2019
Pika 10 Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit	PËR MIRATIMIN E LISTËS SË PESTË PARAPRAKE TË 4 FAMILJEVE, QË KANË HUMBUR SHTËPITË INDIVIDUALE SI PASOJË E SHEMBJES NGA TËRMETI I DATËS 26 NËNTOR 2019, TË CILËT DO TË PËRFITOJNË NGA PROGRAMI I ZHVILLIMIT TË ZONAVE TË REJA
Pika 11 Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit të komisioneve të këshillit	PËR MIRATIMIN E NJË NDRYSHIMI NË ANEKSIN NR.1, TË VENDIMIT TË KËSHILLIT BASHKIAK NR.49, DATË 31.05.2022 , PËR FAMILJEN LULA
Pika 12 Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit të komisioneve të këshillit	PËR MIRATIMIN E NJË NDRYSHIMI NË ANEKSIN NR.1, TË VENDIMIT TË KËSHILLIT BASHKIAK NR.154, DATË 22.12.2022, PËR FAMILJEN LOÇI

Atëherë përsa i përket rendit të ditës kemi ndonjë koment nga ana këshilltarëve?

Atëherë komente nuk ka, kalojmë në votim.

Kush është pro miratimit të rendit të ditës?

Kundra?

Abstenim ?Nuk ka.

Atëherë me 32 vota pro miratohet rendi i ditës.

- Kalojmë në projektvendimin e **pikës 1**, i japim fjalën Komisionit Rregullores, Çështjeve Juridike znj. Alneida Rroshi.

Alneida Rroshi: Komisioni Rregullores dhe Çështjeve Ligjore pasi mori në shqyrtim relacionin dhe projektvendimin për projekt zbatimin për ndërtimin e shëtitorës së plazhit Durrës propozon në mënyrë unanime për ta kaluar në votim. Faleminderit.

Ani Dyrmishi : Faleminderit znj.Rroshi.

I japim Komisionit të Pronave Publike, Transportit dhe Trafikut Rrugor znj. Mustafaraj.

Zamira Mustafaraj: Edhe Komisioni i Pronave dhe Transportit unanimitisht vendosi për kalimin në votim të kësaj pike.

Ani Dyrmishi : Faleminderit.

Atëherë përsa i përket pikës 1, kemi komente nga ana e këshilltarëve?

Komente nuk ka, kalojmë në votim.

Kush është pro miratimit të pikës 1 të rendit të ditës?

Kundra?....

Abstenim ?Nuk ka.

Atëherë me 32 vota pro miratohet dhe pika 1 e rendit ditës.

- Kalojmë në projektvendimin për **pikën 2**, i japim fjalën Komisionit Rregullores dhe Çështjeve Juridike znj. Rroshi.

Alneida Rroshi: Komisioni i Rregullores dhe Çështjeve Juridike pasi mori në shqyrtim pikën 2 propozon unanimitisht për ta kaluar në votim. Faleminderit.

Ani Dyrmishi : Faleminderit.

Komisioni i Strehimit dhe Shërbimeve Publike znj. Budini.

Etleva Budini: Edhe komisioni ynë pas shqyrtimit të materialeve të vëna në dispozicion nga bashkia, vendosi unanimitisht për miratimin e kësaj pike.

Ani Dyrmishi : Faleminderit .

Komisioni Zhvillimit Urban dhe Përdorimit të Tokës znj. Velçani.

Etleva Velçani: Kryetar faleminderit.

Komisioni i Zhvillimit Urban dhe Përdorimit të Tokës pasi shqyrtoi relacionin dhe projektvendimin vendosi kalimin në votim. Faleminderit.

Ani Dyrmishi : Faleminderit .

Komente përsa i përket pikës 2 të rendit të ditës, kemi nga ana e këshilltarëve?

Komente nuk ka, kalojmë në votim.

Kush është pro miratimit të pikës 2 të rendit të ditës?

Kundra?....

Abstenim ?Nuk ka.

Atëherë me 32 vota pro miratohet dhe pika 2 e rendit ditës.

- Kalojmë në projektvendimin për **pikën 3**, i japim fjalën znj. Rroshi.

Alneida Rroshi: Pas shqyrtimit të relacionit dhe projektvendimit për pikën 3, komisioni ynë propozon për ta kaluar në votim. Faleminderit.

Ani Dyrmishi : Faleminderit.

Komisioni i Strehimit dhe Shërbimeve Publike znj. Budini.

Etleva Budini: Gjithashtu komisioni ynë votoi unanimitisht për kalimin e kësaj liste me 11 subjekteve përfituese për votim në mbledhjen e sotme.

Ani Dyrmishi : Faleminderit .

Komisioni Zhvillimit Urban dhe Përdorimit të Tokës znj. Velçani.

Etleva Velçani: Edhe komisioni ynë është dakort për kalimin në votim për këtë pikë. Faleminderit.

Ani Dyrmishi : Faleminderit.

Atëherë komente përsa i përket pikës 3 të rendit të ditës, kemi nga ana e këshilltarëve?

Atëherë komente nuk ka, kalojmë në votim.

Kush është pro miratimit të pikës 3 të rendit të ditës?

Kundra?....

Abstenim ?Nuk ka.

Atëherë me 32 vota pro miratohet dhe pika 3 e rendit ditës.

- Kalojmë në projektvendimin për **pikën 4**, i japim fjalën Komisionit Rregullores dhe Çështjeve Juridike znj. Rroshi.

Alneida Rroshi: Komisioni i Rregullores pasi mori në shqyrtim propozimin për ndryshimin e VKB-së nr.155, propozon unanimitisht për ta kaluar në votim.

Ani Dyrmishi : Faleminderit.

Komisioni i Strehimit dhe Shërbimeve Publike znj. Budini.

Etleva Budini: Gjithashtu dhe komisioni ynë, vendosi unanimitisht për kalimin në votim.

Ani Dyrmishi : Faleminderit .

Komisioni Zhvillimit Urban dhe Përdorimit të Tokës znj. Velçani.

Etleva Velçani: Edhe komisioni ynë gjithashtu vendosi unanimitisht për kalimin në votim.

Ani Dyrmishi : Faleminderit .

Komente përsa i përket pikës 4 të rendit të ditës, kemi?

Nuk ka, kalojmë në votim.

Kush është pro miratimit të pikës 4 të rendit të ditës?

Kundra?....

Abstenim ?Nuk ka.

Atëherë me 32 vota pro miratohet dhe pika 4 e rendit ditës.

- Kalojmë në projektvendimin për **pikën 5**, znj. Rroshi.

Alneida Rroshi: Edhe për pikën 5 komisioni ynë votoi unanimitisht për ta kaluar në votim.

Ani Dyrmishi : Faleminderit.

Komisioni i Strehimit dhe Shërbimeve Publike znj. Budini.

Etleva Budini: Edhe Komisioni i Strehimit dhe Shërbimeve Publike, vendosi unanimitisht për miratimin e kësaj liste.

Ani Dyrmishi : Faleminderit.

Znj. Velçani.

Etleva Velçani: Gjithashtu dhe komisioni ynë propozon kalimin në votim.

Ani Dyrmishi : Faleminderit .

Atëherë përsa i përket pikës 5, kemi ndonjë koment nga ana e këshilltarëve?

Komente nuk ka, kalojmë në votim.

Kush është pro miratimit të pikës 5 të rendit të ditës?

Kundra?....Nuk ka.

Abstenim ?Nuk ka.

Atëherë me 32 vota pro miratohet dhe pika 5 e rendit ditës.

- Kalojmë në projektvendimin për **pikën 6**, znj. Rroshi.

Alneida Rroshi: Pasi morëm në shqyrtim dhe pikën 6 propozojmë për ta kaluar në votim.

Ani Dyrmishi : Faleminderit.

Znj. Budini.

Etleva Budini: Gjithashtu dhe komision ynë vendosi pro miratimit të këtyre shtesave.

Ani Dyrmishi : Faleminderit .

Znj. Velçani.

Etleva Velçani: Edhe komisioni ynë është dakort për kalimin në votim.

Ani Dyrmishi : Faleminderit .

Atëherë përsa i përket pikës 6, kemi ndonjë koment nga ana e këshilltarëve?

Komente nuk ka, kalojmë në votim.

Kush është pro miratimit të pikës 6 të rendit të ditës?

Kundra?....Nuk ka.

Abstenim ?Nuk ka.

Atëherë me 32 vota pro miratohet dhe pika 6 e rendit ditës.

- Kalojmë në projektvendimin për **pikën 7**, znj. Rroshi.

Alneida Rroshi: Pasi morëm në shqyrtim relacionin për ndryshime dhe shtesave në VKB nr.34 propozojmë për ta kaluar në votim.

Ani Dyrmishi : Faleminderit.

Znj. Budini.

Etleva Budini: Edhe komision ynë vendosi pro miratimit të këtyre shtesave.

Ani Dyrmishi : Faleminderit .

Znj. Velçani.

Etleva Velçani: Gjithashtu dhe komisioni ynë është dakort për kalimin në votim.

Ani Dyrmishi : Faleminderit .

Atëherë përse i përket pikës 7, kemi ndonjë koment nga ana e këshilltarëve?

Atëherë komente nuk ka, kalojmë në votim.

Kush është pro miratimit të pikës 7 të rendit të ditës?

Kundra?....Nuk ka.

Abstenim ?Nuk ka.

Atëherë me 32 vota pro miratohet dhe pika 7 e rendit ditës.

- Kalojmë në projektvendimin për **pikën 8**, znj. Rroshi.

Alneida Rroshi: Pasi shqyrtuam dhe pikën 8 propozojmë për ta kaluar në votim.

Ani Dyrmishi : Faleminderit.

Znj. Budini.

Etleva Budini: Komision ynë unanimisht është pro miratimit.

Ani Dyrmishi : Faleminderit.

Znj. Velçani.

Etleva Velçani: Edhe komisioni ynë është pro kalimit në votim.

Ani Dyrmishi : Faleminderit .

Atëherë përse i përket pikës 8, koment nga ana e këshilltarëve kemi ?

Atëherë komente nuk ka, kalojmë në votim.

Kush është pro miratimit të pikës 8 të rendit të ditës?

Kundra?.....

Abstenim ?Nuk ka.

Atëherë me 32 vota pro miratohet dhe pika 8 e rendit ditës.

- Kalojmë në projektvendimin për **pikën 9**, znj. Rroshi.

Alneida Rroshi: Pasi shqyrtuam pikën 9 komisioni ynë propozon për ta kaluar në votim.

Ani Dyrmishi : Faleminderit.

Znj. Budini.

Etleva Budini: Edhe komision ynë propozon unanimit për ta kaluar.

Ani Dyrmishi : Faleminderit.

Znj. Velçani.

Etleva Velçani: Gjithashtu dhe komisioni ynë është dakort për kalimin në votim.

Ani Dyrmishi : Faleminderit .

Komente përsa i përket pikës 9, kemi nga ana e këshilltarëve?

Atëherë komente nuk ka, kalojmë në votim.

Kush është pro miratimit të pikës 9 të rendit të ditës?

Kundra?.....

Abstenim ?Nuk ka.

Atëherë me 32 vota pro miratohet dhe pika 9 e rendit ditës.

- Kalojmë në projektvendimin për **pikën 10**, znj. Rroshi.

Alneida Rroshi: Pasi shqyrtuam dhe pikën 10 unanimit propozojmë për ta kaluar në votim.

Ani Dyrmishi : Faleminderit.

Znj. Budini.

Etleva Budini: Edhe komisioni ynë ka vendosur unanimit për kalimin e kësaj pike.

Ani Dyrmishi : Faleminderit.

Znj. Velçani.

Etleva Velçani: Edhe Komisioni Zhvillimit Urban dhe Përdorimit të Tokës vendosi me vota unanime për kalimin në votim.

Ani Dyrmishi : Faleminderit .

Përsa i përket pikës 10, kemi ndonjë koment nga ana e këshilltarëve?

Atëherë komente nuk ka, kalojmë në votim.

Kush është pro miratimit të pikës 10 të rendit të ditës?

Kundra?.....

Abstenim ?Nuk ka.

Atëherë me 32 vota pro miratohet dhe pika 10 e rendit ditës.

- Kalojmë në projektvendimin për **pikën 11**, znj. Rroshi.

Alneida Rroshi: Pasi morëm në shqyrtim kërkesën e familjes Lula përfshirë në VKB nr.49 propozojmë për ta kaluar në votim.

Ani Dyrmishi : Faleminderit.

Znj. Budini.

Etleva Budini: Gjithashtu dhe komisioni ynë në bashkëpunim me Komisionin e Çështjeve Ligjore ka vendosur unanimitisht për ta kaluar në votim. Më falni ka vendosur me shumicë votash.

Ani Dyrmishi : Faleminderit .

Përsa i përket pikës 11, kemi ndonjë koment nga ana e këshilltarëve?

Nuk ka, kalojmë në votim.

Kush është pro miratimit të pikës 11 të rendit të ditës?

Kundra?.....

Abstenim ?Nuk ka.

Atëherë me 32 vota pro miratohet dhe pika 11 e rendit ditës.

- Kalojmë në projektvendimin për **pikën 12**, znj. Rroshi.

Alneida Rroshi: Pasi morëm në shqyrtim kërkesën e familjes Loçi përfshirë në VKB nr.154, propozojmë unanimitisht për ta kaluar në votim.

Ani Dyrmishi : Faleminderit.

Znj. Budini.

Etleva Budini: Gjithashtu dhe komisioni ynë vendosi unanimitisht për ta kaluar këtë pikë në votim.

Ani Dyrmishi : Faleminderit .

Përsa i përket pikës 12, kemi ndonjë koment nga ana e këshilltarëve?

Atëherë koment, po. Zonja Diana .

Adriana Hatellari : Si këshilltarë me të drejtën, me detyrën që na është caktuar “Ne”, më falni për zërin, mendoj që do të ishte më mirë, që “Ne” të mblidhemi si grup këshilltarë jo të zgjidhim problemet që janë mëse të drejta dhe mëse që duhen zgjidhur se s’bën të këtyre familjeve, por mbase duhet të mblidheshim që të gjejmë një mekanizëm që këto probleme personale t’i zgjidhim nëpërmjet një vendimi, apo një amendamenti, apo një interpelance që t’i

jepnim zgjidhje jo vetëm atyre, që arrijnë të ankohen e u është marrë parasysh kjo ankesa, por edhe të tjerë që nuk kanë mundur të vinë dot tek “Ne”. Domethënë të gjehet një mekanizëm që tu bëhet një zgjidhje këtyre problemeve. Faleminderit .

Ani Dyrmishi : Faleminderit znj. Diana. Shpresoj që në bashkëpunim me Komisionin e Ligjeve do të mendojmë një zgjidhje të tillë, faleminderit për sygjerimin.

Komente të tjera ka , përsa i përket kësaj pike ?

Nuk ka, kalojmë në votim.

Kush është pro miratimit të pikës 12 të rendit të ditës?

Kundra?.....Nuk ka.

Abstenim ?Nuk ka.

Atëherë me 32 vota pro miratohet dhe pika 12 dhe e fundit e rendit ditës.

Nuk e ka kërkuar asnjë fjalën për diskutim.

Kryetare keni fjalën nëse dëshironi ta merrni.

Emiriana Sako : Jo, faleminderit.

Ani Dyrmishi : Mbledhjen e deklaroj të mbyllur.

Për mbledhjen e radhës jeni njoftuar nga sekretaria e këshillit.

Ky procesverbal mbyllet me nr. rendor 10 (dhjetë) faqe, i cili pasi verifikohet firmoset nga Komisioni i Verifikimit të Procesverbalit, sipas Rregullores Këshillit dhe Procesverbalit të Kryesisë dhe 2 Kryetarëve të Grupeve Politike në Këshill së datës 09.06.2022.

Mbajtësi i procesverbalit: Dorina Milja

Komisioni i Verifikimit të Procesverbalit :

Kryetar i Këshillit Bashkiak :

ANI DYRMISHI

Zëvendëskryetare e Këshillit :

ZAMIRA MUSTAFARAJ

Sekretare e Këshillit Bashkiak :

DORINA MILJA

Kryetar i Grupit të Partisë Socialiste të KB :

AFRIM BAKAJ

Kryetar i Grupit të Pavarur të KB :

ETLEVA VELÇANI